

20110240593

L I G J PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR PRONËSI INDUSTRIALE

Neni 1

Në Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pronësi industriale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 21/2009), në nenin 52 paragrafi (2) fjalët: "afat prej gjashtë muajsh", zëvendësohen me fjalët: "afat prej dymbëdhjetë muajsh".

Neni 2

Në nenin 121 paragrafi (2) fjalët: "301 paragrafi (5)", zëvendësohen me fjalët: "297 paragrafi (5)".

Neni 3

Neni 231 ndryshohet si vijon:

"(1) Me emrin e mbrojtur gjeografik shënohen prodhimet natyrore, prodhimet industriale joushqimore, prodhimet zejtare dhe prodhimet e artizanatit.

(2) Me emrin e mbrojtur gjeografik shënohen edhe prodhimet bujqësore, prodhimet ushqimore, prodhimet industriale ushqimore, që nuk janë përfshirë me Ligjin për kualitet të prodhimeve bujqësore."

Neni 4

Neni 318 ndryshohet si vijon:

"(1) Nëse inspektori përcakton se janë shkelur të drejtat e pronësisë industriale përkohësisht do t'i marrë sendet me të cilat është bërë kundërvajtja dhe do të japë vërtetim për sendet e marra përkohësisht në rastin kur:

- në mënyrë të paautorizuar shfrytëzohet shpikja e mbrojtur;
- në mënyrë të paautorizuar shfrytëzohet ose imitohet dizajni i mbrojtur industrial;
- në mënyrë të paautorizuar shfrytëzohet ose imitohet marka e mbrojtur tregtare dhe
- në mënyrë të paautorizuar shfrytëzohet ose imitohet marka e mirënjohur tregtare.

(2) Nëse inspektori përcakton se janë shkelur të drejtat e pronësisë industriale nga paragrafi (1) i këtij neni do të miratojë aktvendim me të cilin do të urdhërojë të tërhiqen nga përdorimi pajisjet, mjetet dhe dokumentet me të cilat është kryer kundërvajtja dhe do të përcaktojë afat për tërheqjen e tyre.

(3) Nëse personi juridik ose fizikë nuk vepron sipas urdhrit nga paragrafi (2) i këtij neni inspektori do të miratojë aktvendim për ndalimin e përkohshëm të kryerjes së veprimtarisë në kohëzgjatje prej 30 ditësh për personin juridik, ndërsa për personin fizik prej 15 ditësh, do t'i vulosë lokalet në të cilat kryhet veprimtaria, do t'i marrë pajisjet, mjetet dhe dokumentet në lidhje me to dhe do të japë vërtetim për pajisjet, mjetet dhe dokumentet e marra përkohësisht.

(4) Prodhimet, pajisjet, mjetet dhe dokumentet e marra përkohësisht nga paragrafët (1) dhe (3) të këtij neni, inspektori detyrohet që t'ia dorëzojë gjykatës kompetente."

Neni 5

Në nenin 321 në paragrafin (1) shuma "8 000" zëvendësohet me shumën "6 000".

Në paragrafin (1) pikat 1, 2, 3, 4 dhe 5 ndryshohen si vijojnë:

"1) në mënyrë të paautorizuar merret me përfaqësimin e personave juridikë dhe fizikë (nenet 22 dhe 279);

2) në mënyrë të paautorizuar shfrytëzon shpikje të paraqitur ose të mbrojtur (neni 291 paragrafi (2));

3) në mënyrë të paautorizuar shfrytëzon ose imiton dizajn të paraqitur ose të mbrojtur industrial (neni 291 paragrafi (2));

4) në mënyrë të paautorizuar shfrytëzon ose imiton markë të paraqitur ose të mbrojtur tregtare (neni 291 paragrafët (2) dhe (3)) dhe

5) në mënyrë të paautorizuar shfrytëzon ose imiton markë tregtare të mirënjohur (neni 291 paragrafët (2) dhe (3))."

Neni 6

Në nenin 322 paragrafi (1) pika 2 fjalët: "paragrafët (3) dhe (4))" zëvendësohen me fjalët: "paragrafi (2)".

Pas paragrafi t (3) shtohet paragrafi i ri (4), si vijon:

"(4) Për kundërvajtjet nga paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni, inspektori detyrohet që kryerësit të kundërvajtjes t'i propozojë procedurë për barazim në pajtim me Ligjin për kundërvajtje, para se të parashtrijë kërkesë për ngritje të procedurës kundërvajtëse."

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".